

BANKA	Gjendja sipas monedhes		31 Dhjetor 2023		31 Dhjetor 2022
			Kursi konvertimit sipas bankes se Shqiperise	Sipas kursit te Bankes Shqiperise	
		31.12.2023			
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre				589,791,514.52	259,250,841.11
Mjete monetare në BANKA				589,790,721.45	252,249,943.31
Credins bank	ALL	26,456,151.49		26,456,151.49	246,058,481.34
Credins bank	Euro	481.48	103.88	50,016.14	0
Credins bank PR 2	ALL	562,373,483.00		562,373,483.00	0
Raiffeisen bank	ALL	475,940.15		475,940.15	920,421.56
Raiffeisen bank	Euro	44.34	103.88	4,606.04	13,186.71
Raiffeisen bank	\$	16.6	93.94	1,559.40	8,200.02
Intesa Sanpaolo Bank	ALL	45,193.73		45,193.73	445,281.44
Intesa Sanpaolo Bank	Euro	778.20	103.88	80,839.42	157,645.40
Intesa Sanpaolo Bank	\$	3,224.74	93.94	302,932.08	4,646,726.84
Te tjera					
Mjete Monetare ne ARKE				793.07	897.79
Mjete monetare në arkë	ALL	33.67		33.67	33.67
Mjete monetare në arkë	Euro	0.98	103.88	101.81	118.34
Mjete monetare në arkë	\$	7	93.94	657.59	745.79

AKTIVE TE TJERA FINANCIARE AFATSHKURTRA

Kërkesat e arkëtueshme pa faturë dhe aktive të tjera financiare, në fillim dhe fund të ushtrimit kontabël:

Aktive të tjera financiare afatshkurtra	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2023	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2022
(1) Të drejta të arkëtueshme (FSH Minifutbolli debitore)	156,700.00	156,700.00
(2) Të drejta të arkëtueshme (TSG 2022)		130,080.60
(3) Të drejta të arkëtueshme (Trajnerë të Projektit TSON)	35,300.00	35,300.00
(4) Të drejta të arkëtueshme (YAD 1, TSG, Kurs trajnerë)	1,171,990.60	
(5) Të drejta të arkëtueshme (Bursa Olimpikë "Paris" dhe "Milano")	3,414,480.00	
TOTALI	4,778,470.60	322,080.60

Në zërin: Të drejta të arkëtueshme janë paraqitur të drejta të arkëtueshme nga:

- FSH Minifutbolli për akomodim ekipi, shtesë në Lojrat e Plazhit "Pescara 2015" në vlerën 156,700.00 Lekë, debitore që në vitin 2015,
- "Talent Sot Olimpist Nesër" në shumën 35,300.00 Lekë,
- Balanca të Youth Athlete Development, TSG Basketboll & Volejball dhe Kurs trajnerësh në shumën 1,171,990.60 dhe
- Bursa Olimpikë për periudhën Shtator – Dhjetor 2023 në shumën 3,414,480.00 Lekë.
Të gjitha sa më sipër janë shpenzuar gjatë vitit 2023 e më parë, dhe fondet për mbulimin e tyre priten të arkëtohen gjatë vitit 2024.

Kërkesat e arkëtueshme me faturë, në fillim dhe fund të ushtrimit kontabël:

Aktive të tjera financiare afatshkurtra	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2023	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2022
(1) Të drejta të arkëtueshme One Albania	2,597,000.00	
TOTALI	2,597,000.00	

Të drejta të arkëtueshme me faturë në shumën 2,597,000.00 Lekë është paraqitur kësti i dytë i sponsorit One Albania faturuar gjate vitit 2023 dhe arketuar ne janar 2024.

IVENTARET DHE SHPENZIMET E PARAPAGUARA

Iventaret dhe shpenzimet e parapaguara në datë 31.12.2023 paraqiten si vijon:

Iventaret dhe Shpenzimet e parapaguara	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2023	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2022
(1) Inventarët per projektin Sportiv	283,749.55	22,969,140.00
(2) Iventaret per aktivitetet e tjera	1,149,142.50	1,169,897.51
(3) Shpenzime të parapaguara		18,278,400.00
TOTALI	1,432,892.05	42,417,437.51

Vlerat dhe zërat analitike të gjendjeve inventariale të pasqyruara në bilanc në mënyrë të përmbledhur në tabelën e mësipërme janë të përputhura me të dhënat e kontabilitetit dhe të inventarizimeve fizike që organizata ka kryer në 31 Dhjetor 2023.

AKTIVET AFATGJATA MATERIALE (AAM-te)

Gjendjet dhe lëvizjet e aktiveve afatgjata materiale në pasqyrat financiare paraqitet si vijon:

	Gjendjet dhe lëvizjet	Toka	Ndertesa	Mjete transporti	Pajisje dhe orendi	TOTALI
A	Kosto e AAM-ve me 01.01.2023	-	8,772,149.20	6,616,757.17	19,490,734.72	34,879,641.09
	Shtesat	-			19,939,832.58	19,939,832.58
	Pakesimet	-	-			0.00
	Kosto e AAM-ve 31.12.2023	-	8,772,149.20	6,616,757.17	39,430,567.30	54,819,473.67
B	Amortizimi AAM-ve 01.01.2023	-	4,552,183.27	5,000,836.69	6,648,395.82	16,201,415.78
	Amortizimi ushtrimit	-	438,607.46	323,184.10	5,197,550.79	5,959,342.35
	Amortizimi per daljet e AAM-ve	-	-	-	-	-
	Amortizimi i AAM-ve 31.12.2023	-	4,990,790.73	5,324,020.79	11,845,946.61	22,160,758.13
C	Zhvleresimi AAM-ve 01.01.2023	-	-	-	-	-
	Shtesat	-	-	-	-	-
	Pakesimet	-	-	-	-	-
	Zhvleresimi AAM-ve 31.12.2023	-	-	-	-	-
D	Vlera neto e AAM-ve 01.01.2023	-	4,219,965.93	1,615,920.48	12,842,338.90	18,678,225.31
	Vlera neto e AAM-ve 31.12.2023	-	3,781,358.47	1,292,736.38	27,584,620.69	32,658,715.54

Vlerat dhe klasifikimi në grupe i AAM-ve të pasqyruara në bilanc dhe në tabelën e mësipërme janë të përpëthura me të dhënat e kontabilitetit dhe të inventarizimeve fizike që organizata e ka kryer në 31 Dhjetor 2023.

Ndryshimi i AAM vjen si rezultat i pakësimit për amortizim në shumën 5,959,342.35 Lekë, dhe blerje të AAM në shumën 19,939,832.58 Lekë.

Në marrëveshje me Sigal Uniqa Group Austria, KOKSH ka në përdorim dy makina për nevoja të institucionit të cilat do të regjistrohen në pronësi të KOKSH sipas marrëveshjes.

DETYRIME AFATSHKURTRA

Detyrimet afatshkurtra në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabël 2023 paraqiten si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2023	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2022
Detyrime afatshkurtra		
(1) Personeli e llogari të lidhura me to	2,158,667.00	727,658.00
(2) Detyrime ndaj Shtetit për tatim-taksa	6,656,055.67	2,577,475.00
(3) Sigurime shoqërore& shëndetësore	2,333,337.00	1,161,968.00
(4) Të tjera detyrime	20,843,418.94	17,943,047.50
(5) Kontribute të marra në avance		
TOTALI	31,991,478.61	22,410,148.50

Në detyrimet afatshkurtra zëri Të tjera detyrime prej 20,843,418.94 Lekë është analizuar si më poshtë vijon:

Geraldina Sposa në vlerën 7,654,928.50 Lekë

Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare në vlerën 1,741,500.00 Lekë

TCT Premium në vlerën 426,006.00 Lekë

Bursa Olimpikë Paris Shtator – Dhjetor 2023 në vlerën 2,841,900.00 Lekë

Bursa Olimpikë Milano Cortina Nëntor – Dhjetor 2023 në vlerën 572,580.00 Lekë

TSG Volejboli në vlerën 328,242.00 Lekë

TSG Basketboli në vlerën 236,825.00 Lekë

Youth Athlete Development në vlerën 277,053.60 Lekë

Kursi trajnerëve të atletikës në vlerën 329,870.00 Lekë

Detyrim ndaj AOSH në vlerën 70,590.00 Lekë

Detyrim ndaj Furnizuesi i Shërbimit Universal Dhjetor 2023 në vlerën 48,399.20 Lekë.

Detyrim ndaj Europetrol Durres në vlerën 345,168.00 Lekë

Detyrim ndaj Information Business Solution 5,020,836.00 Lekë

Detyrim ndaj Alfa SHA në vlerën 949,520.00 Lekë

KONTRIBUTE TE MARRA NE AVANCE

Në këtë zë janë pasqyruar të ardhura gjatë vitit 2022-2023, por që i takojnë shpenzimeve që do të kryhen për aktivitetet e vitit 2024, si më poshtë vijon:

Kontribute të marra në avancë	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2023	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2022
Fonde të donatorëve	521,830.60	3,710,302.20
Fonde për Projektin Ekipet Sportive 2022	26,506,167.63	273,154,290.87
Fonde për Projektin Ekipet Sportive 2023	555,734,233.00	
TOTALI	582,762,231.23	276,864,593.07

Me Vendimin Nr.870 datë 30/12/2021 Qeveria akordoi një fond prej 500.000.000.00 Lekë për Projektin e madh Sportiv në mbështetje dhe masivizimin e ekipeve sportive të volejball e basketbollit nëpër shkollat e gjithë Republikës. Projekti shtrihet në një periudhë një vjeçare Qershor 2022 deri Qershor 2023 periudhë që përkon me vitin shkollor. Nga Fondi i akorduar prej 500.000.000.00 Lekë gjatë vitit 2022 u shpenzuan 226,845,709.00 Lekë, gjate vitit 2023 do te shpenzohej diferenca prej 273,064,431.00 Lekë, por për arsye tenderimi të Bluzave Inteligjente për matjen e parametrave të fëmijëve, projekt pilot ky i cili është bërë për herë të parë në Universitetin e Bolonjës dhe do të aplikohet në 200 fëmijë pjesë të ekipeve sportive në shkolla, vlera prej 26,506,167 Lekë do të shpenzohet gjatë vitit 2024 (pra kjo vlerë është vecuar dhe do të meret si e ardhur gjatë vitit 2024)

Me Vendimin Nr.893 datë 27/12/2022 Qeveria akordoi një fond prej 250.000.000.00 Lekë si dhe me Vendimin Nr.709 datë 06/12/2023 Qeveria akordoi një fond prej 350.000.000.00 Lekë për Projektin “Ekipet Sportive ne Shkolla” në mbështetje dhe masivizimin e ekipeve sportive të volejball e basketbollit nëpër shkollat e gjithë Republikën. Gjatë muajit dhjetor 2023 e shpenzuan për këtë projekt vlera prej 44.265,767 Lekë dhe teprica prej 555,734,233 do të jenë të ardhura për vitin 2024 e vijim.

Nga fondet e Qeverisë dhe donatorëve, fondet e ardhura gjatë vitit 2023 janë si vijon:

TE ARDHURAT

Gjatë vitit 2023, KOKSH ka përfituar këto të ardhura:

PASQYRA E TE ARDHURAVE TE KOMITETIT OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR			
		31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022
1	Qeveria “Ekipet Sportive 2022”	246,558,263.00	226,935,569.13
2	Qeveria “Ekipet Sportive 2023”	44,265,766.67	
3	Të ardhurat nga donacionet		
	a- Të ardhurat nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar e Solidariteti Olimpik	25,885,886.66	37,442,678.92
	b- Të ardhurat nga Komiteti Olimpik European	16,569,344.88	18,682,571.03
	c- Të ardhurat nga Komiteti Organizator Lojërave	0	
	d- Të ardhurat nga TOP Partner	3,186,945.45	4,311,324.90
4	Të ardhurat nga Grande Qeveritare		
	a- Buxheti Shtetit	12,940,000.00	12,900,000.00
	b- Klubi Sportiv Tirana	0	1,055,254.00
5	Të ardhurat nga sponsorizime	19,678,087.49	0
6	Të ardhurat nga tarifat e anëtarësimit	230,000.00	610,010.00
7	Të ardhura të tjera	1,189,754.59	1,249,234.41
	TOTALI	370,504,048.74	303,186,642.39

Në zërin “Të ardhurat nga tarifat e anëtarësimit” janë pasqyruar pagesat e kryera nga anëtarët si vijon 14 anëtarë për vitin 2022 dhe 9 anëtarë për vitin 2023.

“Të ardhurat nga sponsorizime” ne vleren prej 19,678,087.49 leke janë sponsorizime në vlerë ose në natyrë si më poshtë vijon:

- Credins Bank në vlerën 7,793,800.00 Lekë
- X One Shpk në vlerën 1,751,170.00 Lekë
- One Albania në vlerën 5,207,500.00 Lekë
- The Plaza Tirana sponsorizim në natyrë me vlerë 3,745,137.49 Lekë

- Alfa SHA sponsorizim në natyrë në vlerën 949,520.00 Lekë
“Të ardhura të tjera” janë 4 projekte me Erasmus plus të përfituara.
“Të ardhura të tjera” perfaqson subjektin Sigal Uniqa Group Austria-dhurim (pjesa e amortizimit) mjete në përdorim në vlerën 1,180,480.00 Lekë
Fondi i përfituar nga Buxheti i Shtetit (Ministria e Arsimit) prej 12,940,000.00 Lekë gjatë vitit 2023 nuk u përdor plotësisht dhe vlera prej 6,976.00 Lekë u rikthye në Buxhet.

PASQYRA E FONDEVE TE KTHYERA NE BUXHETIN E SHITETIT			
		31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022
1	Fonde te papërdorura (kthyer në Buxhet)	6,976.00	9,027.00

SHPEZIMET

Tabela e shpenzimeve të vitit 2023 është paraqitur e kombinuar sipas natyrës dhe aktiviteteve në përputhje me *burimin e financimit*, sipas preventivave të miraturara dhe Aktiviteteve të zhvilluara, si më poshtë:

PASQYRA E SHPEZIMEVE TE KOMITETIT OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR			
		31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022
A	Projekti “Ekipet Sportive 2022”	245,950,038.41	226,935,569.13
	a-Uniforma Sportive (Tuta, Atlete, canta peshqira corape, uniforma ndeshjesh)		165,692,880.00
	b-Paga administrate dhe sigurime	77,586,526.00	11,444,785.00
	c-Burime njerëzore të jashtme (mesues trajnere e kordinatorë)	88,472,305.00	23,941,000.00
	d- Shërbim për publikimin e projektit (Tibo)	34,981,652.00	23,418,920.00
	e- Akomodim dhe transport për event	21,996,636.00	1,455,848.00
	f- Sigurim i shëndetit të fëmijëve	8,864,370.00	
	g- Evente Sportive	15,069,310.00	
	h- Të tjera shpenzime operative të administrimit	34,525,804.00	745,310.00
	i- Amortizimi	4,719,202.00	236,827.00
B	Projekti “Ekipet Sportive 2023”	44,265,766.67	
	a-Paga trajnerë dhe kordinatorët	44,261,666.67	
	b-Komision bankar	4,100.00	
C	Mbështetje financiare (Federatave dhe Shoqatave)	7,993,333.67	21,768,297.61
	a-Atletika	1,127,670.04	2,130,380.00
	b-Basketbolli	990,725.00	1,775,806.00
	c-Boksi	0	850,000.00
	d-Çiklizmi	1,027,986.10	1,011,888.10
	e-Hendbolli	144,826.76	0
	f-Karate	144,560.00	1,608,670.00
	g-Mundje	590,593.00	2,695,000.00
	h-Noti	24,695.00	0
	i-Ping Pong	0	350,000.00

	j-Qitje	0	618,200.00
	k-RadioAmatorizëm	200,000.00	350,000.00
	l-Sporti Shkollor	0	88,722.00
	m-Skitë	0	3,500,000.00
	n-Taekwondo	752,025.00	3,319,150.11
	o-Tenis	1,097,845.00	0
	p- Xhudo	0	400,000.00
	q-Volejball	1,392,408.00	2,720,481.40
	r- Vrojtuesit e Plazhit dhe shpëtimit në ujë	0	350,000.00
	s- Mbështetje financiare për sëmundje	500,000.00	0
D	Bursa Olimpikë dhe Talentet e Reja	11,835,881.60	13,872,183.32
	a- Bursa Olimpikë "Milano Cortina 2026"	572,580.00	0
	b- Bursa "Talent Sot Olimpist Nesër"	2,437,053.60	0
	c-Bursa Olimpikë "Paris 2024"	8,826,248.00	10,302,912.00
	d- Bursa Olimpikë "Pekin 2022"	0	3,569,271.32
E	Shpenzime për aktivitete të ndryshme	35,013,629.78	25,514,083.02
	a- Lojërat Olimpikë "Pekin 2022"	0	4,172,730.17
	b- Lojërat Mesdhetare "Oran 2022"	0	5,181,592.84
	c- Lojërat Islamike "Konya 2022"	0	3,264,285.55
	d- EYOF Veror dhe Dimëror 2022	2,813,882.62	6,317,887.23
	e- Aktivitete të tjera (Asamble, Seminare, takime etj)	28,780,347.74	6,577,587.23
	f- Lojërat Europiane "Krakow 2023"	2,381,227.27	
	g- Lojërat e Plazhit "Heraklion 2023"	1,038,172.15	
F	Shpenzime administrimi dhe të tjera të përgjithshme	23,304,884.25	22,201,104.34
	TOTALI I SHPENZIMEVE	368,370,510.38	310,300,264.42

Në mënyrë të përmblëdhur të ardhurat dhe shpenzimet sipas dy grup aktiviteteve kryesore kanë qenë si vijon:

	Pershkrimi	31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022
A	Te ardhura Projekti sportiv 1	262,491,213.00	226,935,569.13
	Shpenzime per Projektin sportiv 1	245,950,038.41	226,935,569.13
	Rritja/Rënia e aktiveve neto (A)	16,541,174.59	0
B	Te ardhura Projekti sportiv 2	44,265,766.67	
	Shpenzime per Projektin sportiv 2	44,265,766.67	
	Rritja/Rënia e aktiveve neto (B)	0	
C	Të ardhurat nga donacionet	63,747,069.07	76,251,073.26
	Shpenzimet per aktivitetet e lidhura	78,154,705.30	83,364,695.29
	Rritja/Rënia e aktiveve neto (C)	(14,407,636.23)	(7,113,622.03)

Gjatë vitit 2023 janë zhvilluar shumë aktivitete, për të cilat janë dhënë shënimet përkatëse në Raportin e Performancës.

RRITJA/ RENIA E AKTIVEVE NETO

Në 31.12.2023 gjendja e ndryshimeve në aktivet neto paraqitet si vijon:

Pershkrimi	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2023	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2022
Të ardhurat	370,504,048.74	303,186,642.39
Shpenzimet	368,370,510.38	310,300,264.11
Rritja/Rënia e aktiveve neto	2,133,538.36	(7,113,621.72)

Siç vërehet sa më sipër, KOKSH ka një rritje të aktiveve neto prej 2,133,538.36 Lekë gjatë vitit 2023.

Shënime të tjera:

Ngjarjet e ndodhura pas datës së bilancit për të cilat bëhen rregullime apo ngjarjet e ndodhura pas datës së bilancit për të cilat nuk bëhen rregullime nuk ka.

Gabime materiale të ndodhura në periudhat kontabël të mëparshme të konstatuara gjatë periudhës raportuese nuk ka.

Me Vendim të Këshillit të Ministrave është miratuar fond për Projektin “Ekipet Sportive 2022,, në vlerën 500,000,000.00 Lekë. Ky fond është pasqyruar në Pasqyrat Financiare të vitit 2022.


Vlera e përdorur nga ky fond gjatë vitit 2023 është 245,950,038.41 Lekë.

Sekretari i Përgjithshëm

Gerti Skrimo




Hartuesi i Pasqyrave Financiare

Esmeralda Imeraj


RAPORTI PERFORMANCES VITI 2023

1. Objektivat dhe aktivitetet

"Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH) është Person Juridik që organizohet dhe funksionon si organizatë jofitimprurëse. KOKSH është e organizuar mbi bazën e parimeve të Kartës Olimpike. Qëllimi i kësaj organizate është të promovojë dhe të udhëheqë Lëvizjen Olimpikë në Shqipëri.

Për vitin 2023, objektivi kryesor i KOKSH ishin "EKIPET SPORTIVE NE SHKOLLA", si projekt që bëhej për herë të parë në Shqipëri në këto përmasa.

Qëllimi kryesor i projektit Ekipet Sportive 2023 ka qenë masivizimi i sportit në shkolla për moshat 08 vjec – 18 vjec.

Në të njëjtën kohë KOKSH ka patur objektiv edhe përgatitjen dhe pjesëmarrjen në aktivitete të rëndësishme si: Lojërat Europiane "Krakoë 2023", Lojërat e Plazhit "Heraklion 2023", EYOF veror "Maribor 2023" dhe EYOF Dimëror "FVG 2023".

Financuesit kryesorë të veprimtarisë së KOKSH për vitin 2023 kanë qenë Qeveria Shqiptare dhe donatorët Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (IOC), Komiteti Olimpik European (EOC).

2. Arritjet dhe performance

- Në fushën ndërkombëtare

Gjatë këtij viti, me fonde të donatorëve të huaj, u mundësua pjesëmarrja në aktivitete të rëndësishme si Lojërat Europiane "Krakoë 2023", Lojërat e Plazhit "Heraklion 2023", EYOF veror "Maribor 2023" dhe EYOF Dimëror "FVG 2023". Gjatë këtij viti u arritën rezultate të larta nga ana e sportistëve tanë.

Në kuadër të bashkëpunimit rajonal (Ballkani Perëndimor) janë zhvilluar disa takime pune midis KOKSH dhe Komiteteve Olimpikë të Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut, Bosnie Herzegovinës. Gjithashtu takime pune janë zhvilluar nga Presidenti i KOKSH me Personalitete të Federatave të ndryshme. Me kërkesë të Presidentit z. Fidel Ylli, KOKSH bëri hostin e Mbledhjes së Bordit Ekzekutiv të ICMG.

- Në zbatim të "Projektit Ekipet Sportive në Shkolla" për vitin e dytë të janë hapur 772 ekipe sportive në 61 Bashki në të gjithë Shqipërinë. Ekipet sportive, janë organizuar në dy disiplina Volejboll dhe Basketboll, me një numër total fëmijësh 10151 fëmijë pjesë të ekipeve sportive. Janë aktivizuar 400 mësues të Edukimit Fizik sipas njohurive përkatëse Volejboll dhe Basketboll të cilët kryejnë trajnim të ekipeve sportive të hapura në shkolla të ndryshme të vendit. Janë aktivizuar rreth 40 kordinatorë të cilët janë angazhuar në terren me Ekipet sportive (zv kordinatorë Volejbollit, Zv.Kordinatorë basketbollit dhe Kordinatori i përgjithshëm i Bashkisë) të cilët kordinojnë punën me trajnerët për mbarëvajtjen e procesit të stërvitjes dhe performancës së ekipeve të secilës Bashki.

Projekti Ekipeve Sportive ka bërë të mundur, plotësimin me set uniformash (komplet tuta të gjata komplete uniformash për ndeshje, canta, peshqirë, çorape, xhupa shiu). Janë shpërndarë topa basketbolli dhe volejboli për të gjithë Ekipeve sportive.

Janë kryer matjet antropometrike funksionale të fëmijëve në fillim të periudhës stërvitore (Tetor 2022 dhe Maj 2023), për të parë ndryshimet që kanë pësuar fëmijët nga aktivizimi i tyre në sport, si dhe për të evidentuar fëmijët me probleme të ndryshme të shtyllës kurrizore, apo probleme të tjera fizike.

Në periudhën Mars 2023-Qershor 2023 u kryen ndeshjet lokale, rajonale dhe kampionati ndërmjet ekipeve përfaqesuese përkatësisht vajza, djem, dhe në të dy disiplinat Volejbolli dhe Basketbolli.

- KOKSH ka vijuar gjatë vitit 2023 mbështetjen e sportistëve cilësorë me Bursa Olimpikë në kuadër të përgatitjes për Lojërat Olimpikë "Paris 2024". Konkretisht nga ky program i Solidaritetit Olimpik, KOKSH ka mundësuar përftimin e Bursave për 10 sportistë të Federatave të ndryshme: Atletikë, Boks, Çiklizëm, Gjimnastikë, Mundje, Ping-Pong, Qitje dhe Xhudo.

Gjithashtu filloi mbështetja e sportistëve cilësorë me Bursa Olimpikë në kuadër të përgatitjes për Lojërat Olimpikë "Milano Cortina 2026". Konkretisht nga ky program i Solidaritetit Olimpik, KOKSH ka mundësuar përftimin e Bursave për 2 sportistë të Federatës së Skive.

- Një vëmendje i është kushtuar edhe Talenteve të Reja. Janë mbështetur financiarisht 8 sportistë të Federatave të ndryshme, për të arritur rezultate sa më të larta, si potencial për të qënë Olimpistët e ardhshëm.
- Gjatë vitit 2023, KOKSH ka mbështetur financiarisht disa Federata Sportive sipas projekteve të miratuara për Kurse të Trajnerëve dhe për pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme.

Departamenti i Medias dhe Komunikimit kryen në mënyrë periodike rregjistrimin dhe transmetimin direkt të aktiviteteve që zhvillohen nga KOKSH. Vlen të përmenden transmetimet live të ndeshjeve të ekipeve sportive pjesë e projektit në kanalën SportAlb, në rrjetet sociale Facebook dhe Instagram. Në vitin 2023 Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar është renditur i 4 për shikueshmërinë në 256 Komitete Olimpikë në të gjithë botën.

Departamenti i Medias dhe Komunikimit së bashku me Departamentin e Teknologjisë së Informacionit ka nxjerrë edicionin e parë të revistës Team Albania.

Departamenti i Teknologjisë së Informacionit – ka kryer një punë të madhe në ngritjen e serverave të brendshëm për të ruajtur sigurinë e informacionit.

- Raportimi financiar

Raportimi Financiar është bërë duke plotësuar pasqyrat financiare për Organizatat Jo Fitimprurëse dhe Shënimet për pasqyrat financiare sipas Standartit Kombëtar të Kontabilitetit 15 për OJF-të.

Në Pasqyrën e Pozicionit Financiar janë paraqitur Aktivet (mjetet monetare në arkë dhe llogari rrjedhëse, kontribute të arkëtueshme nga debitorët, gjendja e inventarit), Detyrimet (detyrime për blerje apo shpenzime të papaguara gjatë vitit 2023) dhe për diferencë Aktivet Neto të KOKSH. Gjatë vitit 2023 kemi rritje në Aktivet Neto, në vlerën 2,133,538 Lekë.

Në Pasqyrën e Aktiviteteve (apo performances) janë paraqitur të ardhurat e realizuara dhe shpenzimet e kryera gjatë vitit 2023.

Në Pasqyrën e Flukseve të Mjeteve Monetare janë pasqyruar para të arkëtuara dhe pagesa të kryera gjatë vitit

2023. Në këtë pasqyrë kemi rritje neto të flukseve të parase, për arsye të fondeve të dhëna nga Qeveria Shqiptare për Projektin 2 "Ekipe Sportive në Shkollë", në mbështetje të masivizimit të sportit të Basketbollit dhe Volejbollit .

Në mënyrë periodike nga departamenti financës raportohet pranë KE , Sekretarit të Përgjithshëm dhe Presidentit për përdorimin e burimeve financiare sipas projekteve dhe destinacioneve të përcaktuara nga donatorët.

Veprimtaria e departamentit të financës rregullohet nga statuti dhe rregullorja e brendshme të cilat janë respektuar gjatë aktivitetit të vitit 2023.

3. Struktura, drejtimi dhe raportimi (pas Asamblesë Zgjedhore)

KOKSH është rregjistruar në Gjykatë me Vendimin Nr.5934 datë 22.06.2018, me NIPT K21709003M. Adresa në të cilën zhvillon veprimtarinë e tij KOKSH është Rruga Liman Kaba, Parku Olimpik dhe

Rruga Muhamet Gjollësja, Sheshi Mustafa Q. Atatürk (ish 21 —Dhjetori)

KOKSH drejtohet nga Asambleja e Përgjithshme dhe Komiteti Ekzekutiv. Komiteti Ekzekutiv përbëhet nga:

Fidel Ylli	President
Erlind Pëllumbi	Zv/ President
Julinda Dhame	Mbajtës Thesari
Alfred Tahiraj	Anëtar
Dritan Shakohoxha	Anëtar
Enkelejda Caushi	Anëtare
Florend Kalivopulli	Anëtar
Izmir Smajlaj	Anëtar
Labo Capo	Anëtar
Luiza Gega	Anëtare
Tonin Binoshaj	Anëtar

Gjatë vitit 2023 janë zhvilluar katër mbledhje të Komitetit Ekzekutiv si organ vendim marrës për pjesëmarrje në aktivitete ndërkombëtare, mbështetje financiare për Federatën sportive dhe sportistët elitare si dhe talente të reja. E është marrë iniciativa për zhvillimin e Ëestern Balkan International Games e cila do të bashkojë 6 - shtete të Ballkanit Perëndimor, Shqipëri, Mal i Zi Kosovë, Maqedoni e Veriut, Bosnje Herxegovina Gjithashtu një nga projektet madhështore të KOKSH është krijimi i Qendrës Olimpikë dhe gjetja e investitorëve potencial për ndërtimin e kësaj qendre.

Sekretar i Përgjithshëm
Gerti Shima.



Shtojca 1

KOMITETI OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR
Pasqyra e Pozicionit Financiar
31 dhjetor 2023

	2023	2022
AKTIVET		
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	589,791,515	252,250,841
Të drejta dhe interesi i arkëtueshëm		
Kontribute të arkëtueshme- pa fature	4,778,471	322,081
Kontribute të arkëtueshme -faturim	2,597,000	
Inventarë dhe shpenzime të parapaguara	1,432,892	24,139,038
Shpenzime periudhave ardhme		18,278,400
Investime financiare afat gjata		
Aktive të kufizuara për investime në toka, ndërtesa dhe pajisje		
Toka, ndërtesa dhe pajisje		
<i>Ndertesat</i>	3,781,358	4,219,966
<i>Instalime teknike, etj</i>	2,362,295	2,339,797
<i>Mjete transporti</i>	1,292,736	1,615,920
<i>Pajisje zyre dhe informatike</i>	27,584,621	12,842,338.90
Investime të tjera afat gjata (mj.transp.ne perdorim)	11,582,970	
Totali i aktiveve	645,203,858	316,008,381
DETYRIMET		
Të pagueshme		
<i>Paga</i>	2,158,667	727,658
<i>TAP dhe Sigurime</i>	2,333,337	1,161,968
<i>TATIM BURIM</i>	6,656,056	2,667,335
<i>Te tjera te pagueshme</i>	16,256,948	17,943,048
<i>Te ardhura te pritshme-per shp.kryera dhe qe I takojn 2023 te pafaturuara</i>	4,586,471	
Dëftesa të pagueshme		
Kontribute të marra në avancë	582,762,231	276,774,733
Grante-sponsor per mjete transporti ne perdorim	11,582,970	
Premtime të kushtëzuara për të dhënë (marrë)		
Hua afat gjatë		
Totali i detyrimeve	626,336,680	299,274,742
AKTIVET NETO	18,867,178	16,733,640
Të kufizuara		
a) Tokë ose vepra arti të dhuruara për t'u përdorur për qëllime specifike me përcaktimin që të ruhen apo të mos shiten		
b) Aktive të dhuruara me qëllimin për t'u investuar dhe siguruar prej tyre burime të përhershme të ardhurash		
Të pakufizuara	18,867,178	16,733,640
Totali i aktiveve neto	18,867,178	16,733,640

Sekretari i Pergjithshem

Gent. Saimo




Hartuesi i Pasqyrave Financiare

Emrable Jusaj



Shtojca 2

KOMITETI OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR
Pasqyra e Aktiviteteve (performancës)
31 dhjetor 2023
(Shpenzimet të paraqitura sipas funksionit)

Përshkrimi i zërit	2023	2022
Ndryshimi në aktivet neto të pakufizuara:		
Të ardhurat:		
Të ardhura nga tarifat e anëtarësimit	230,000	610,010
Të ardhura nga donacionet nderkombetare	46,831,932	60,436,575
Të ardhura nga grantet qeveritare -buxheti shtetit	12,940,000	13,955,254
Të ardhura nga sponsorizimet apo dhurimet	19,678,087	1,249,234
Tarifat për shërbimet		
Të ardhura nga aktivitetet tregtare		
Të ardhura të tjera-Projektet Sportive (VKM-dhjetor 2021)	246,558,263	226,935,569
Të ardhura të tjera-Projektet Sportive (2)	44,265,767	
Totali i të ardhurave nga aktivet neto të pakufizuara	370,504,049	303,186,642
Aktive neto të çliuara nga kufizimet:		
Totali i të ardhurave nga aktivet neto të pakufizuara:		
Shpenzime për aktivitetet me fondet e donatoreve		
Mbeshtetje financiare (Federatave dhe Shoqatave)	7,993,334	21,768,298
Bursa Olimpikë dhe Talentet e Reja (Sportistet)	11,835,882	13,872,183
Aktivite të Ndryshme	35,013,630	25,514,084
Shpenzime administrimi dhe të tjera të përgjithshme	20,767,351	20,772,027
Amortizimi	2,537,533	1,429,077
Kthim fonde ne Buxhet (fond i paperdorur)	6,976	9,027
Totali i shpenzimeve	78,154,705	83,364,695
Shpenzimet per Projektin Sportiv (VKM)		
Materiale Sportive		165,692,880
Administrative(paga e sigurime)	77,586,526	11,444,785
Burime njezore te jashtme	88,472,305	23,941,000
Sherbim per publikimin e projektit (Tibo)+publicitet	34,981,652	23,418,920
Akomodim dhe transport per event	21,996,636	1,455,848
Sigurim i shendetit te femijeve	8,864,370	
Evente Sportive	15,069,310	
Te tjera shpenzime operative te administrimit	38,525,804	745,310
Amortizimi	4,719,202	236,827
Totali i shpenzimeve	290,215,805	226,935,569
Rritja/Rënia në aktivet neto të pakufizuara (A)	2,133,538	(7,113,622)
Ndryshimi në aktivet neto të kufizuara:		
Kontributet		
Të ardhurat nga investimet afat gjata		
Fitimi i realizuar dhe i perealizuar nga investimet afatgjata		
Humbja aktuariale nga obligacioni vjetor		
Aktivitet neto të çliuara nga kufizimet (me shenjë minus)		
Rritja/Rënia në aktivet neto përkohësisht të kufizuara (B)		
Ndryshimi në aktivet neto (A + B)	2,133,538	(7,113,621.72)
Aktive neto në fillim të vitit	16,733,640	23,847,262
Aktive neto në fund të vitit	18,867,178	16,733,640

Sekretari i Përgjithshëm

Gente Shkimo



Hartuesi i Pasqyrave Financiare

Esmeralda Jureq

Shtojca 3

KOMITETI OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR
Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare
31 dhjetor 2023
Metoda Indirekte

AKTIVITETET E SHFRYTËZIMIT	2023	2022
Ndryshimet në aktivet neto	2,133,461	(7,113,622)
Rregullimet për përputhjen e ndryshimeve në aktivet neto me flukset neto		
Amortizimi dhe zhvlerësimi	7,256,889	1,665,904
Humbjet e realizuara dhe të porealizuara në investime		
Humbjet nga dalja jashtë përdorimit e makineri pajisjeve		
Kontributet jo në para		
Rritjet / Rëniet jo në para të inventarëve		
Kontributet e kufizuara për investime në dhurime / ndihma		
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet afatshkurtra:		
Të tjera të arkëtueshme	(7,053,390)	5,945,099
Shpenzime të parapaguara	40,984,545	(41,265,969)
Bamirësi në mirëbesim të arkëtueshme	9,491,470	21,968,981
Të pagueshme	305,987,498	268,676,231
Bamirësi mbi baza vjetore		
Flukse neto nga aktivitetet e shfrytëzimit	358,800,474	249,876,624
AKTIVITETET INVESTUESE		
Blerje / Shitje investimesh		
Blerje / Shitje e Aktiveve afatgjata	(21,259,800)	(13,525,552)
Principal i arkëtuar nga dëftesat e arkëtueshme		
Dhurime e Aktiveve afatgjata	(11,582,970)	
Flukse neto nga aktivitetet investuese	(32,842,770)	(13,525,552)
AKTIVITETET FINANCUERE		
Arkëtime nga kontributet e kufizuara për investime në dhurime	11,582,970	
Principal i paguar për dëftesat e pagueshme		
Flukse neto nga aktivitetet financuese	11,582,970	
Rritje / Rënie neto e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre	337,540,674	236,351,072
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të periudhës	252,250,841	15,899,769
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fund të periudhës	589,791,515	252,250,841
Mjete monetare të paguara gjatë periudhës për interesa		

Sekretari i Pergjithshem

Geeta Shimon
[Signature]



Hartuesi i Pasqyrave Financiare

Esmeralda Juceq
[Signature]

Emertimi dhe Forma ligjore:	“KOMITETI OLIMPIK SHQIPTAR” OJF
NIPT –i:	K21709003M
Adresa e Selise:	TIRANE
Data e regjistrimit:	10/09/2014
Nr. I Regjistrimit Tregtar:	3559
Veprimtaria Kryesore:	Organizate Jo Fitimprurëse

PASQYRAT FINANCIARE

(Në zbatim të Standartit Kombëtar të Organizatave Jo Fitimprurëse)

VITI 2023

Pasqyrat Financiare jane individuale
Pasqyrat Financiare jane te shprehura ne Lek
Pasqyrat Financiare nuk jane te rrumbullakosura
Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare nga 01.01.2023-31.12.2023
Data e mbylljes se Pasqyrave Financiare 06.03.2024

Pasqyra e Pozicionit Financiar
31 dhjetor 2023

	2023	2022
AKTIVET		
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	589,791,515	252,250,841
Të drejta dhe interesi i arkëtueshëm		
Kontribute të arkëtueshme – pa fature	4,778,471	322,081
Kontribute të arkëtueshme - faturim	2,597,000	
Inventarë dhe shpenzime të parapaguara	1,432,892	24,139,038
Shpenzime periudhave ardhme		18,278,400
Investime financiare afat gjata		
Aktive të kufizuara për investime në toka, ndërtesa dhe pajisje		
Tokë, ndërtesa dhe pajisje		
<i>Ndertesë</i>	3,781,358	4,219,966
<i>Instalime teknike, etj</i>	2,362,295	2,339,797
<i>Mjete transporti</i>	1,292,736	1,615,920
<i>Pajisje zyre dhe informatike</i>	27,584,621	12,842,339
Investime të tjera afat gjata	11,582,970	
Totali i aktiveve	645,203,858	316,008,381
DETYRIMET		
Të pagueshme		
<i>Paga</i>	2,158,667	727,658
<i>TAP dhe Sigurime</i>	2,333,337	1,161,968
<i>TATIM BURIM</i>	6,656,056	2,577,475
<i>Te tjera te pagueshme</i>	16,256,948	17,943,048
<i>Te ardhura te pritshme per shpenzime qe I takojne 2023 te pafaturuara</i>	4,586,471	
Dëftesa të pagueshme		
Kontribute të marra në avancë	582,762,231	276,864,593
Grante- sponsor per mjete transporti ne perdorim	11,582,970	
Premtime të kushtëzuara për të dhënë		
Hua afat gjatë		
Totali i detyrimeve	626,336,680	299,274,742
AKTIVET NETO	18,867,178	16,733,640
Të kufizuara		
a) Tokë ose vepra arti të dhuruara për t'u përdorur për qëllime specifike me përcaktimin që të ruhen apo të mos shiten		
b) te tjera te kufizuara		

Të pakufizuara	18,867,178	16,733,640
Totali i aktiveve neto	18,867,178	16,733,640

Sekretari i Përgjithshëm

Geeta Saima

[Signature]



Pasqyra e Aktiviteteve (performancës)

31 Rikujtor 2023

(Shpenzimet të paraqitura sipas funksionit)

Hartuesi i Pasqyrave Financiare

Emeraldo Jmeraj

Përshkrimi i zërit	2023	2022
Ndryshimi në aktivet neto të pakufizuara (A)		
Të ardhurat:		
Të ardhura nga tarifat e anëtarësimit	230,000	610,010
Të ardhura nga donacionet dhe kontributet vullnetare	46,831,932	60,436,575
Të ardhura nga grantet qeveritare apo nga agjenci të tjera të financimit	12,940,000	13,955,254
Të ardhura nga sponsorizimet apo dhurimet	19,678,087	1,249,234
Tarifat për shërbimet		
Të ardhura nga aktivitetet tregtare		
Të ardhura të tjera-Projektet Sportive (Projekti 1)	246,558,263	226,935,569
Të ardhura të tjera-Projektet Sportive (Projekti 2)	44,265,767	
Totali i të ardhurave nga aktivet neto të pakufizuara	370,504,049	303,186,642
Shpenzime për aktivitetet olimpike		
Mbështetje financiare (Federatave dhe Shoqatave)	7,993,334	21,768,298
Bursa Olimpik dhe Talentet e Reja (Sportistët)	11,835,882	13,872,183
Aktivite të Ndryshme	35,013,630	25,514,083
Shpenzime administrimi dhe të tjera të përgjithshme	20,767,351	22,201,104
Amortizimi	2,537,533	1,429,077
Kthim fonde në Buxhet (fond i papërdorur)	6,976	9,027
Totali i shpenzimeve për aktivite olimpike	78,154,705	83,364,695
Shpenzimet për Projektet Sportive		
Materiale Sportive		165,692,880
Administrative (paga e sigurime)	77,586,526	11,444,785
Burime njerëzore të jashtme	88,472,305	23,941,000
Shërbim për publikimin e projektit (Tibo)	34,981,652	23,418,920
Akomodim dhe transport për event	21,996,636	1,455,848
Sigurim i shëndetit të fëmijëve	8,864,370	
Evente Sportive	15,069,310	
Të tjera shpenzime operative të administrimit	38,525,804	745,310
Amortizimi	4,719,202	236,827

Totali i shpenzimeve të Projekteve sportive	290,215,805	226,935,569
Rritja/Rënia në aktivet neto të pakufizuara (A)	2,133,538	(7,113,622)
Ndryshimi në aktivet neto të kufizuara:		
Rritja/Rënia në aktivet neto përkohësisht të kufizuara (B)		0
<i>Ndryshimi në aktivet neto (A + B)</i>	<i>2,133,538</i>	<i>(7,113,622)</i>
Aktive neto në fillim të vitit	16,733,640	23,847,262
Aktive neto në fund të vitit	18,867,178	16,733,640

Sekretari i Përgjithshëm

Gerti Shima
[Signature]



Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare

31 dhjetor 2023

Metoda Direkte

Hartuesi i Pasqyrave Financiare

Esmeralda Tureaj
[Signature]

Përshkrimi i zërave	2023	2022
Flukset nga aktivitetet e shfrytëzimit		
Para të arkëtuara nga kontribute të pakufizuara	663,057,147	577,938,054
Para të arkëtuara nga përfituesit e shërbimeve		
Grante I pagueshëm / kthyeshëm		
Të paguara për punonjësit dhe furnitorët	(145,036,382)	(307,802,542)
Të paguara për kordinatorë, mesues e dieta	(159,419,581)	(21,671,855)
Interesa dhe komisione,	(240,348)	(80,364)
Flukse neto nga aktivitetet e shfrytëzimit	358,360,837	248,383,293
Flukset nga aktivitetet investuese		
Kontribute të kufizuara		
Blerje/Shitje investimesh		
Blerje/Shitje të aktiveve afatgjata materiale	(19,939,833)	(11,889,698)
Flukse neto nga aktivitetet investuese	(19,939,833)	(11,889,698)
Flukse nga aktivitetet financuese		
Arkëtime nga kontributet e kufizuara për investime në dhurime / ndihma		
Principal i paguar për dëftesat e pagueshme		
Flukse neto nga aktivitetet financuese		
Rritje / Rënie neto e flukseve	338,421,004	236,493,595
Efektet nga kursi i këmbimit	(880,330)	(142,523)
Gjendje në fillim të periudhës	252,250,841	15,899,769
Gjendje në fund të periudhës	589,791,515	252,250,841

Sekretari i Përgjithshëm

Gerti Shima
[Signature]



Hartuesi i Pasqyrave Financiare

Esmeralda Tureaj
[Signature]

Metoda Indirekte

AKTIVITETET E SHFRYTËZIMIT		2023	2022
Ndryshimet në aktivet neto		2,133,461	(7,113,622)
Rregullimet për përputhjen e ndryshimeve në aktivet neto me flukset neto nga aktivitetet e shfrytëzimit:			
	Amortizimi dhe zhvlerësimi	7,256,889	1,665,904
	Humbjet e realizuara dhe të porealizuara në investime		
	Humbjet nga dalja jashtë përdorimit e makineri pajisjeve		
	Kontributet jo në para		
	Rritjet / Rëniet jo në para të inventarëve		
	Kontributet e kufizuara për investime në dhurime / ndihma		
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet afatshkurtra:			
	Të tjera të arkëtueshme	(7,053,390)	5,945,099
	Shpenzime të parapaguara	40,984,545	(41,265,969)
	Bamirësi në mirëbesim të arkëtueshme	9,491,470	21,968,981
	Të pagueshme	305,987,498	268,676,231
	Bamirësi mbi baza vjetore		
Flukse neto nga aktivitetet e shfrytëzimit		358,800,474	249,876,624
AKTIVITETET INVESTUESE			
	Blerje / Shitje investimesh		
	Blerje / Shitje e Aktiveve afatgjata	(21,259,800)	(13,525,552)
	Principal i arkëtuar nga dëftesat e arkëtueshme		
	Blerje/dhurim e Aktiveve afatgjata	(11,582,970)	
Flukse neto nga aktivitetet investuese		(32,842,770)	(13,525,552)
AKTIVITETET FINANCUESE			
	Arkëtime nga kontributet e kufizuara për investime në dhurime	11,582,970	
	Principal i paguar për dëftesat e pagueshme		
Flukse neto nga aktivitetet financuese		11,582,970	
Rritje / Rënie neto e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre		337,540,674	236,351,072
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të periudhës		252,250,841	15,899,769
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fund të periudhës		589,791,515	252,250,841
Mjete monetare të paguara gjatë periudhës për interesa			

Sekretari i Përgjithshëm

Geeta Skrimuz
[Signature]



Hartuesi i Pasqyrave Financiare

Emeralda Duroj *[Signature]*

SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE 2023

“KOMITETI OLIMPIK SHQIPTAR” OJF është regjistruar si organizatë jo fitimprurëse në formën e shoqatës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me Vendimin Nr 5934 datë 22/06/2018, e indentifikuar me NIPT K21709003M.

KOKSH në fillim të vitit 2023 ka patur 43 anëtarë. Gjatë vitit 2023 janë miratuar edhe 4 Komitete Olimpikë Rajonale.

Organet drejtuese sipas Statutit janë:

- Asambleja e Përgjithshme si Organ Vendimmarrës
- Komiteti Ekzekutiv, si organ ekzekutiv

President i shoqatës është Z. Fidel Ylli, dhe Sekretar i Përgjithshëm Z. Gerti Shima me funksion në administrimin e saj dhe përfaqësimin tek palët e treta.

Objekti kryesor i shoqatës është si më poshtë:

Misioni i KOKSH-it është të zhvillojë, promovojë dhe të mbrojë Lëvizjen Olimpikë në Shqipëri në përputhje me Kartën Olimpikë si dhe masivizimin e sportit në shkolla.

Organizimi dhe funksionimi i saj rregullohet sipas legjislacionit shqiptar për OJF-të dhe Statuti i saj i miratuar në vitin 2022.

Politikat kontabël

Politikat kryesore kontabël të adoptuara për përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare paraqiten si më poshtë. Këto politika janë zbatuar në mënyrë konsistente në të gjithë vitet e paraqitura, përveç kur përcaktohet ndryshe.

1. Baza e përgatitjes së Pasqyrave Financiare

Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit për OJF, i cili bazohet në Ligjin Nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

Standardi I Kontabilitetit për përgatitjen e pasqyrave financiare për OJF i referohet tri lloj informacionesh që pasqyrat financiare duhet t’u ofrojnë përdoruesve: rreth pozicionit financiar, performancës dhe fluksit të mjeteve monetare

Pozicioni financiar i KOKSH është përcaktuar nga aktivet, detyrimet dhe aktivet neto në fund të periudhës raportuese, ndërsa performanca përcaktohet nga marrëdhënia mes të ardhurave të saj dhe shpenzimeve gjatë periudhës raportuese.

Pasqyrat financiare të KOKSH, referuar Standartit të OJF-ve-paragrafi 26, zbatojnë kontabilitetin me të drejta dhe detyrime të konstatuara.

2. Përmbledhje e politikave dhe rregullave kryesore kontabël

Vijimësia

Hartimi i pasqyrave financiare të KOKSH është bërë sipas parimit të vijshmërisë së aktivitetit. Shifrat koresponduese të bilancit janë mbartur korrekt në çelje.

Monedha funksionale e paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave

Pasqyrat Financiare paraqiten në monedhën vendase Lekë (ALL), e cila është monedha funksionale dhe raportuese e KOKSH. Informacioni financiar është paraqitur në Lekë.

Fondet e hyra dhe shpenzimet janë shprehur në Lekë. Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë me kursin e këmbimit në ditën e transaksionit. Diferencat që rezultojnë janë të njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën.

Njohja e burimeve dhe përdorimeve (shpenzimeve)

Burimet financiare të vitit ushtrimor 2023 përbëhen nga: Fondi i Qeverisë Shqiptare për “Ekipet Sportive 2022”, donacione të organizatave ndërkombëtare (IOC dhe EOC), Fondi buxhetor nga MAS, kuotat e anëtarësimit e të ardhura të tjera brenda dhe jashtë vendit të dedikuara për vitin 2022.

Shpenzimet financiare të paraqitura në pasqyrë janë të gjitha shpenzimet që i takojnë periudhës ushtrimore 2022.

Vlerësimi Aktiveve Afatgjata Materiale

Sipas politikave kontabël të organizatës vlera e aktiveve afatgjata materiale njihet si aktiv në momentin e blerjes.

Pakësimi i vlerës së tyre gjatë periudhës raportuese njihet si shpenzim amortizimi.

Shtesat e Aktiveve Afatgjata regjistrohen në kontabilitet me koston e marrjes.

Aktivet monetare (Paraja dhe ekuivalentët e parasë)

Aktivet monetare përfshijnë gjendjen në arkë dhe llogaritë rrjedhëse me bankat. Për qëllime të pasqyrës së fluksit të parasë, paraja dhe ekuivalentët e saj përfshihen si likuiditete në llogaritë rrjedhëse.

Kërkesë për t'u arkëtuar dhe detyrimet për t'u paguar

Kërkesat për t'u arkëtuar dhe detyrimet për t'u paguar në mbyllje të ushtrimit janë paraqitur sipas vlerës së regjistruar në datën e lindjes së tyre me koston historike.

Teprica e burimeve mbi përdorimet

Rritja/rënia midis burimeve dhe përdorimeve që krijohet në ushtrimin kontabël pasqyrohet në fondet e veta (aktivet neto) të organizatës.

Përfitimet e punonjësve dhe tatimi mbi të ardhurat nga punësimi

KOKSH është përgjegjës për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe tatimin mbi të ardhurat nga punësimi të personelit të tij. KOKSH derdh për fondin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore bazuar në pagën e çdo punonjësi dhe paguan tatimin mbi të ardhurat nga punësimi ndaj autoriteteve tatimore. Për rastet e pagesave dhe honororave të tjera sipas rastit mbahet tatim në burim.

Ngjarje pas datës së bilancit

Ngjarjet pas datës së bilancit që përmbajnë informacion shtesë për pozicionin e Organizatës, në datën e Bilancit Kontabël (ngjarjet rregulluese) janë reflektuar në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas bilancit që nuk janë ngjarje rregulluese paraqiten të shpalosura në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare kur janë materiale.

3. Shpjegime për pasqyrat financiare

AKTIVE MONETARE (likuiditete në arkë dhe bankë)

Gjendjet e mjeteve monetare në bankë dhe arkë, në Lekë dhe valutë, në datë 31 Dhjetor 2022 dhe 31 Dhjetor 2023 paraqiten si më poshtë: